




● «Komunistët» - vepër e piktorit Lec Shkreli.

(vijon nga f. 1)
sivisht me tërë jetën e vendit, me gjithë problemet që preokupojnë shoqërinë tonë, në mënyrë që të njohin kushtet në të cilat jeton dhe punon populli, për të cilin krijohet letërsia dhe arti. E themi këtë, pasi ka patur mendime se shkrimtari e artisti i talentuar gjoja mund të krijojë edhe duke punuar në studion e tij pa qenë nevoja të bjerë në kontakt me jetën. Ky mendim idealist është nxjerrur veçanërisht nga F. Pagrami, i cili kërkonte një art thjesht racional e të thatë, të mbështetur vetëm në disa teza abstrakte e të trilluara jashtë terrenit tonë. Këto mendime të tij dalin edhe në «dramat» e tij pa jetë, të mbushura plot me teza thellësisht të gabuara e antikombëtare.

Një synim tjetër i punës është të ngremë figurën e lartë të shkrimtarit e artistit, i cili para së gjithash është personalitet politik e shoqëror; misioni i lartë i artistit tonë të realizmit socialist kërkon që krijuesi të marrë pjesë të plotë e të gjallë në jetën e vendit; nuk ka ngjarje të rëndësishme në jetën politike e ideologjike, ekonomike e kulture, që të mos e interesojë shkrimtarin e ku ai të mos marrë pjesë; ku të mos thotë fjalën e vet. Pikërisht në këtë prirudhë pas Plenumit IV të Komitetit Qendror të PPSH shkrimtarët tanë janë përpjekur me të gjitha forcat për të intensifikuar punën në këtë drejtim, janë marrë një sërë masash organizative e ideologjike, si për forcimin e pasurimin e gjithë sistemit të edukimit marksist-leninist, ashtu edhe për lidhjen e ngushtë me jetën, me punëtorët e kooperativistët. Është një hap i mirë në këtë drejtim gjallërimi i seminarit të edukimit teorik të shkrimtarëve dhe artistëve, që ndiqet me interes nga anëtarët e organizatës sonë krijuese. Në këtë

seminar janë zhvilluar dhe diskutuar disa tema: rreth të cilave kanë patur një farë konfuzioni ideologjik, si karakteri kombëtar i artistit, problemi i heroit, etj. Pikërisht në këto probleme janë bërë vitet e fundit edhe ato teorizime të dëmshme, të cilat kanë goditur karakterin kombëtar të artistit dhe heroin pozitiv, synonin të reviziononin parimin e partishmërisë. Shkrimtarët dhe artistët, duke diskutuar gjërësisht për këto probleme dhe duke shfaqur mendimet e tyre, kanë ndjerë domosdoshmërinë e lidhjes me jetën dhe me problemet e shoqërisë sonë.

Materialet e Plenumit IV të KQ të Partisë përbëjnë në këtë drejtim një program të madh pune e lufte. Prandaj ato qëndrojnë e do të qëndrojnë edhe në të ardhmen në themel të të gjithë veprimtarisë sonë ideologjike dhe organizative. Si të tilla, ato edhe në të ardhmen duhen studjuar akoma më me vëmendje, duhen zëbërthyer e vënë në jetë me kujdes e përgjegjësi. Rëndësi ka që atmosfera e krijuar në sferën e letërsisë e të arteve mbas fjalimeve të vitit të kaluar të shokut Enver Hoxha, fryma e mobilizimit dhe e optimizmit për ndreqjen e të metave, të mbahet gjallë e të çohet më përpara, në mënyrë që lufta kundër shfaqjeve dhe ndikimeve të ideologjisë së huaj të vazhdojë të rritet e të zhvillohet akoma më me forcë.

Jemi në vitin jubilar të 30-vjetorit të lavdishëm të Çlirimit të Atdheut. Të armatosur me mësimet e partisë, të gjitha forcat krijuese do t'i japin popullit vepër të reja, me partishmëri të lartë e nivel të mirë artistik, të denja për epokën tonë të lavdishme.

XHEMAL DINI
Sekretar i përgjithshëm i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë

Folklori dramatik dhe teatri

(vijon nga f. 6)

e bëjnë të kërcejë sipas ritmit të muzikës. Nga një herë këto kërcime plotësohen me biseda e me këngë, të cilat përshkohen nga një ritëm i gjallë e plot optimizëm. (Vetëkuptohet se të gjitha këto i bën vetë mjeshtri popullor i «pehlivanit»). Siç shihet, ky tip kuklle është farefis me marionetat, ndonëse paraqitet më i thjeshtë.

c) «Kopili», është një tip kuklle prej leckash, me madhësi dhe me tipare të ndryshme. Format dramatike më të thjeshta në shfaqjet popullore të «kopilit» janë monologjike, me pjesëmarrjen e një kuklle të vetme. Ka raste kur loja e «kopilit» shtjellohet në dialog; ndonëse vepron një kukull e vetme, sepse midis kësaj dhe kukull-luajtësit thuret një farë bashkëpunimi duke ndryshuar zërin sipas rastit. Qesharake janë sidomos grindjet midis kukllës dhe kukull-luajtësit. Më të zhvilluara nga pikëpamja dramatike janë shfaqjet e «kopilave» me dy kuklla. Këto shfaqje shtjellohen zakonisht me dialogje dhe bëhen tërheqëse kur lojtari do t'i gërshetojë mirë bashkëbisedimet, duke ndryshuar zërin sipas rolit. Kemi edhe shfaqje popullore me dy kuklla që shtjellohen në heshtje; ato janë si pantomima në miniaturë.

Përsa i përket dramatikës ose «mizanskenës» së shfaqjeve popullore me kuklla, mund të themi se edhe kjo ndryshon pak a shumë sipas krahinave dhe sipas etapave të zhvillimit. Në fazën fillestare, kukullluajtësi futet në mes të shikuesve për të dhënë shfaqje, kurse në etapën e dytë, siç do të shohim më poshtë, mbulohet me ndonjë mënyrë, duke lënë jashtë vetëm duart me kuklla. Në këtë etapë loja e kukllave shoqërohet zakonisht me muzikë instrumentale. Le të marrim një shembull nga krahina e Lumës. Sapo zenë të bijnë veglat, futet në dhomë një njeri i mbuluar me qylym, duke ecur sipas ritmit të muzikës. Kur arrin në mes të të pranishmëve qëndron në këmbë, nxjerr përjashta vetëm duart me dy kuklla (zakonisht njëra si femër e tjetra si mashkull) dhe i lëviz sipas ritmit, me poza e veprime të ndryshme; duke shtjelluar një farë pantomime në miniaturë. Së fundi lojtari, i fut duart me kuklla nën qylym dhe tërhiqet së prapthi gjithnjë sipas ritmit të muzikës, deri sa del nga dhoma.

Përveç «kopilave», në Shqipërinë Verilindore kemi një tip shfaqjesh me kuklla mjaft interesante: quhet «musja me burrë në shpinë». Dy personazhet e kësaj shfaqje luhen nga një njeri i vetëm. Ja se si lojtari vishet nga brezi e sipër si burrë, ndërse nga mesi e poshtë vishet si grua; për bark lidh një kukull të madhe, të cinguar në bel (d.m.th. një farë manikini si bust gruaje me fytyrë të langosur). Përveç kësaj kuklle, të cilën e mban horizontalisht, lidh tek ijet një palë tirge të mbushur me kashtë që rrijnë kacavarë pors këmbe e kalorësit. Në këtë mënyrë kuklla me lojtarin duken pors një nuse e krrusur që ka ngarkuar burrin në shpinë.

Po t'i shqyrtojmë dialektikisht lidhjet e ngushta të folklorit me jetën e popullit, bindemi se krijimtaria popullore nuk është një

pasqyrim pasiv i kushteve të shoqërisë përkatëse në etapa të caktuara sepse aty shihen edhe perspektivat e zhvillimit të mëtejshëm. Në një farë vështrimi, tradita popullore i përgjetyrë për më shumë shekuj që i thellojnë rrënjët në humusin e truallit amtar, e që nxjerrin gjithmonë filiza të rinj rreth trungut. Si shembull kuptimplotë munda të marrim shfaqjet e teatrit parti, zan gjatë Luftës Nacionalçlirimtare. Ndonëse pushtuesit e huaj që synonin asgjësimin tonë, përpiguesnin të na i këputnin lidhjet me traditat, në mënyrë që të harrohej e kaluara e lavdishme. të harroheshin përpjekjet e të parëve tanë për liri, prapëseprapë populi ynë i ruajti me ngulm traditat e veta: së bashku me veçoritë që e dallonin nga të huajt ruajti vetëdijën kombëtare.

Krijimtaria popullore, kjo minierë e pasur, që me të drejtë u mbiquajt «visari kombëtar», është një mbështetje, një mburojë kundra rrymave dekadente që përpigën të vërshojnë në artin dhe në kulturën tonë. Prandaj mbështetja në traditat vendase të kujton Anteun e mitologjisë, që mirë e fuqi nga trualli ku vendoste këmbët.

Ashtu siç organizohen festivalet folkloristike për këngët dhe vallet, të organizohen herë pas herë olimpiada shfaqjesh popullore, mund të mblidhet shumë lëndë interesante dhe mund të zbulohen anë të panjohura të visarit tonë kombëtar. Kështu adodhi pak a shumë me lojrat popullore, për të cilat KQ i BRPSH në bashkëpunim me Komitetin e Kulturës Fizike e Sporteve, organizuan në vitet e fundit disa festivale. Nëpërmjet këtyre manifestimeve të bukura dhe të gëzueshme u përtëritën shumë lojra popullore, të cilat po futen prapë në jetën e përditshme të të rinjve tanë si një kërkesë e nevojshme për edukimin fizik dhe për argëtimin e tyre. Në këtë mënyrë nga njëra anë dalin në dritë gjëra të panjohura të visarit tonë kombëtar dhe nga ana tjetër sigurohet vazhdimësia e pandërprerë e traditave popullore. të cilat u trashëguan deri në kohën tonë, duke i ruajtur me ngulm, brez pas brezi. Duke shfrytëzuar gjithë problemet që preokupojnë gjërësisht e në mënyrë krijuese visarin e pagmuar të folklorit tonë dramatik përforcohen tiparet kombëtare të artistit dhe kulturës sonë dhe pasurohet repertori i teatrove, estradave, cirkut, radio-televizionit, operës dhe baletit me vepër origjinale. Ashtu si thotë shokut Enver në Plenumin IV të KQ të PPSH: «Këto vlera të artit përparimtar të kombit tonë janë për ne objekt i një krenarie të ligjshme, janë kontributi ynë në thesarin e kulturës botërore përparimtare. Nëse në shëkuq popull ynë ruajti e zhvilloi më tej këtë kulturë atëherë neve, brezave të shoqërisë socialiste, ra bie barra të luftojmë me pasionin e militantit komunist, për ta ruajtur të pastër atë dhe për ta zhvilluar më tej».

RAMADAN SOKOLI

(Marrë nga kumtesa mbajtur në sesionin shkencor kushtuar problemeve të frymës kombëtare në letërsinë, kulturën dhe artet tona, organizuar nga Instituti i Lartë i Arteve).